

KËRKESË
Nr. 238, datë 31.1.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “TRE R”

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Tiranë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: objekt i pakërkuar.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Tiranë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH TR-2020 000343-5, datë 11.1.2020, për subjektin person juridik “Tre R”, me adresë: Njësia Administrative nr. 9, rruga “H. Dalliu”, godina 10, kati 1, Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Areti Beruka

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2020-000343-5

Datë 11.1.2020

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-TR-2020-000343-2, datë 11.1.2020, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Tre R”, me NIPT: L32208023K, përfaqësues i autorizuar i subjektit (nuk ka), prej datës 11.1.2020 deri në datën 11.1.2020.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 11.1.2020 dhe e njoftoi në datën 13.1.2020.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, germa “d”.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit (nuk ka), neni 20, pika 1/1, ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 600 000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:

- Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave.

- Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Ornela Balla

ID_0401010010



Alma Shalsi

ID_0401080002



Anda Muca

ID_0401030008



Personi i autorizuar i subjektit

Refuzon
Firmën

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti "Tre R" ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë "organit epror" të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.